



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.190/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" SH.P.K. me numër unik identifikues: 810727406, me seli ne rr. "Hasan Prishtina" 360, Obiliq e përfaqësuar nga A.J., me adrese ne rr. "Hysen Terpeza" nr. 74, Prishtine, Drejtor i Përgjithshëm, kundër të paditurës Policia e Kosoves, rr. "Luan Haradinaj" pn, Prishtine, Kosove, me kërkesë për anulimin e kërkesës së Policisë së Kosovës, me nr. DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024 për konfiskimin e garancisë se tenderit si dhe me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme te sigurisë që të shtyhet ekzekutimi i kërkesës nr. DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024, jashtë seancës me datën 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, shpallet JO KOMPETENT, për të vendosur sipas padisë të paditësit Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" SH.P.K. me numër unik identifikues: 810727406, me kërkesë për anulimin e kërkesës së Policisë së Kosovës, me nr. DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024 për konfiskimin e garancisë se tenderit si dhe me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme te sigurisë shtyrje të ekzekutimit të kërkesës nr. DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi dosja e lëndës me nr. KA.nr. 190/24 më të gjitha shkresat e saj i dërgohet Departamentit Ekonomik të Gjykatës Komerciale.

A r s y e t i m

Me datë 16.04.2024 në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative, e paditesi Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" sh.p.k. me numer unik identifikues: 810727406, me seli ne rr. "Hasan Prishtina" 360, Obiliq e përfaqësuar nga A.J., me adrese ne rr. "Hysen Terpeza" nr. 74, Prishtine, Drejtor i Përgjithshëm ka parashtruar padi kundër të paditurës Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj" pn, Prishtine, Kosove, me kërkesë për anulimin e kërkesës së Policisë së Kosovës, me nr. DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024 për konfiskimin e garancisë se tenderit me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme te sigurisë që të shtyhet ekzekutimi i kërkesës së mësipërme.

Në padi dhe në kërkesë për shtyrje te ekzekutimit te kërkesës DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024 ka deklaruar se e paditura ka zhvilluar procedurën e prokurimit me nr. prokurimi 214-23-8647-1-1-1 dhe nr. te brendshëm 214/23/125/111, tenderin me titull: Furnizim Me Uniforme Policore sipas procedurës se hapur për te cilën ka aplikuar paditësi, pra ka dorëzuar tender, por e paditura, me 26/03/2024, ka përcjellë vendimin e datës 25/03/2024 me te cilin kundërligjshëm e ka eliminuar paditësin, ndërsa ka shpallur fitues grupin e operatoreve ekonomik EMPREUS sh.p.k; Seyntex; Boulevard sh. p.k. me oferte e cila eshte per 1.653.420 €, përkatësisht rreth 18,5% më e shtrenjte.

Deklaron se ndaj vendimi për eliminim nuk kanë parashtruar ankesë. Mirëpo, pasi e paditura e ka eliminuar paditësin nga procesi i mëtutjeshëm i prokurimit, ne kundërshtim me Nenin 57. Paragrafi 1. dhe Nenin 65. Paragrafi 4.11, te LPP-se, si dhe ne kundërshtim me aktet nënligjore, ka kërkuar konfiskimin e garancisë se tenderit, përkatësisht polices se sigurisë me nr.: 10000552639.

Ka deklaruar se baza ligjore për paraqitjen e padisë për iniciimin e konfliktit administrativ, është Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, neni 10, paragrafin 1, shprehimisht percakton se: të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar ne procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjore, ndërkaq, po ashtu, bazuar ne paragrafin 1 te nenit 27 te Ligjit Nr. 03/L-202 Për Konfliktet Administrative, parashihet edhe afati ligjor për iniciimin e konfliktit administrativ përmes padisë, ku përcaktohet se: Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, qe nga data e dorëzimit te aktit administrativ përfundimtar palës.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe propozimit për shtyrje të kërkesës, gjykata konstaton se Kërkesa DDMSH 11/5/24/089, nga Policia e Kosovës si autoritet kontraktues në aktivitetin e prokurimit Furnizimi me uniforme standarde të Policisë së Kosovës me Nr. 217-23-8647-1-1-1 pjesa 1, i është drejtuar K.S. PRISING, me kërkesë për konfiskimin e sigurimit të tenderit me kërkesë të parë të Policës së Sigurimit të Tenderit në emër të Operatoreve “Grup i Operatoreve Ekonomik” Poligoni i Shenjëtarisë, me nr. të Policës:10000552639.

Gjykata vlerëson se kërkesa DDMSH 11/5/24/089, nuk konsiderohet vendim përfundimtar ndaj të cilit mund të fillohet procedura administrative në kuptim të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Neni 13, ku përcaktohet se Konflikti administrativ: 1. *Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë dhe 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar, dhe në kuptim të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 44, ku përcaktohet kuptimi i Aktit administrativ: 1. *Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike.**

Sepse, Kërkesa DDMSH 11/5/24/089, nga Policia e Kosovës për konfiskimin e sigurimit të tenderit sipas Policës së Sigurimit të Tenderit në emër të Operatoreve “Grup i Operatoreve Ekonomik” Poligoni i Shenjëtarisë, me nr. të Policës:10000552639, nuk është akt administrativ i njëanshëm dhe as përfundimtar në një procedurë administrative, ngase buron nga një marrëveshje e palëve në këtë rast Policisë së Kosovës si autoritet kontraktues dhe paditësit Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" SH.P.K. me numër unik identifikues: 810727406, në të cilën është shprehur vullneti i dyanshëm i palëve që përmes kontraktimit të garancisë së ofertës me nr. të Policës 10000552638, të bëhet sigurimi i kushteve të tenderit, më çka me urdhër të tenderuesit në këtë rast paditësit- marrësi i Garancisë Kompania e Sigurimeve “Pristig”, ka marrë përgjegjësinë ndaj të paditurës në kuptim të nenit 1083 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89), Kreu XXXVIII, nenet 1083 deri 1087; të cilat përshtatshmërisht vazhdojnë të aplikohen, sipas nenit Neni 1058 të Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në rast të plotësimit të kushteve të cekura në Garanci të paguaj shumen e siguruar.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me një kontest që buron nga një marrëdhënie kontraktuale detyrimore, për të cilën është kompetent Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate, sipas Ligjit (NR. 08/L-015) për Gjykatën Komerciale, Neni 13 ku përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale me juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe kompetenca e secilit departament në Dhomat e Shkallës së Parë. Sipas paragrafit 2 të njejtit Nen, *të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike, e që në nën-paragrafin 1.1 hyjnë kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.*

Ndërsa, në Departamentin për çështje administrative, në shkallë të parë sipas paragrafit 5, të njejtit Nen hyjnë *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të njejtit Nen.*

Prandaj, çështja juridike paditësit Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" SH.P.K. kundër të paditurës Policia e Kosoves, rr. "Luan Haradinaj" pn, Prishtine, Kosove, me kërkesë për anulimin e kërkesës së Policisë së Kosovës, me nr. DDSHM - 11/5/24/089 e datës 02/04/2024 për konfiskimin e garancisë se tenderit si dhe me kërkesë për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë i dërgohet për shqyrtim në Departamentin përkatës të njejtës gjykate.

Për arsyet e cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.190/24, datë 18.04.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate